



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:295853  
Datë: 25.04.2024  
Numri i dokumentit: 05622740

**C.nr.2958/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses R.K. nga fshati P., Komuna Pejë, të cilën e përfaqëson Bajram Mujaj, avokat nga Peja, sipas autorizimit, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Prisig, Rr. "Eduart Liri", në Prishtinë, me bazë juridike zhdëmtim-kompensim dëmi sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro, jashtë seance me datën 25.04.2024, mori dhe përpiloi këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET e tërhequr** padia e paditëses R.K. nga fshati P., Komuna Pejë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Prisig, me seli në Prishtinë, e parashtruar me datë 30.12.2021, me bazë juridike zhdëmtim-kompensim dëmi sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro.

**II.** Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

**Arsyetim**

Në këtë gjykatë, paditësja R.K. nga fshati P., Komuna Pejë, përmes të autorizuarit të saj, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve Prisig, me seli në Prishtinë, me bazë juridike zhdëmtim-kompensim dëmi sipas auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 1.000 euro.

Gjykata, me datën 04.04.2024, ka pranuar parashtresën e paditëses të paraqitur përmes të autorizuarit të saj, me anë të së cilës parashtresë, ka deklaruar se e tërheqë padinë ndaj të paditurës ngase më të paditurën janë pajtuar të lidhin marrëveshje jashtë gjyqësorë në këtë çështje juridik-kontestimore.

Sipas nenit 261 par.1 dhe 2 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi”* dhe *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se I padituri e jep pëlqimin për një*

*gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë”, andaj në referim të kësaj dispozite ligjore dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, rezulton se plotësohen të gjitha kushtet ligjore që padia në këtë çështje kontestimore, të konstatohet e tërhequr.*

Gjykata në bazë të nenit 261 par.1, 2, 3, 4 dhe 5 lidhur me nenin 387 par.1, pika c) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.2958/21, me datë 25.04.2024**

**Gjyqtarja,**  
Rajmonda Kurteshi

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.